REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr._____ /2026

PËR

DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 2, e nenit 3, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet;

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe përcaktohet, si më poshtë:

a) Sipas formulës: Cilindrata në cm^3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit:

i. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij;
ii. Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën, 20 lekë për benzinën dhe 20 lekë për gazin për mjetet me vëllim deri në 2 000 cm^3, për autoveturë, motomjet ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) dhe gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë);
iii. Taksa fikse për llojin e karburantit është 26 lekë për naftën, 21 lekë për benzinën dhe 21 lekë për gazin për mjetet me vëllim më të madh se 2 000 cm^3, për autoveturë, ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) dhe gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë);
iv. Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën, 20 lekë për benzinën dhe 20 lekë për gazin, për autobusët (sipas grupit III të koeficientit të vjetërsisë).

b) Për mjetet elektrike:

i. mjetet elektrike autoveturë, ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë), gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë) dhe autobusët (sipas grupit III të koeficientit të vjetërsisë), paguajnë taksë fikse vjetore 15,000 lekë;
ii. motomjetet elektrike (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) paguajnë taksë fikse vjetore 1,000 lekë.

c) Për rimorkio dhe gjysmërimorkio paguhet taksë:

i. 1 lekë/kg për rimorkio ose gjysmërimorkio me peshë deri në 50000 kg; dhe
ii. 60,000 lekë/taksë fiske për rimorkio ose gjysmërimorkio me peshë mbi 50000 kg.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe i rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të

përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë, sipas nenit 114, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Verifikimi i pagesës së taksës vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP) është detyrim që përmbushet nga Policia e Shtetit. 5 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore.".

3. Në pikën 11 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët "21 000 lekë çdo vit" zëvendësohen me "40 000 lekë çdo vit";
b) Fjalia e fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë për çdo vit, sipas nenit 114, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".

Neni 3

Shkronja "b", e nenit 5, shfuqizohet.

Neni 4

Në pikën 2, të nenit 8, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "b" shfuqizohet;

2. Në shkronjën "c", togfjalëshi "5 për qind" zëvendësohet me "1.8 për qind";

3. Në shkronjën "g", togfjalëshi "5 për qind" zëvendësohet me "1.8 për qind".

Neni 5

Në pikën 6, të nenit 9, hiqen fjalët "... taksës së qarkullimit dhe ...".

Neni 6

Shtojca nr.1 zëvendësohet me shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2027.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

SHTOJCA NR.1
KOEFICIENTËT SIPAS VJETËRSISË PËR TAKSËN VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA

GRUPI I		GRUPI II		GRUPI III	
Motomjete dhe autovetura, ATP		Gjithë të tjerat (APV)		Autobusët	
Mosha e mjetit	Koeficienti	Mosha e mjetit	Koeficienti	Mosha e mjetit	Koeficienti
1	0.15	1	0.15	1	0.04
2	0.16	2	0.17	2	0.05
3	0.17	3	0.19	3	0.06
4	0.18	4	0.21	4	0.07
5	0.19	5	0.23	5	0.08
6	0.2	6	0.25	6	0.09
7	0.21	7	0.27	7	0.1
8	0.22	8	0.29	8	0.11
9	0.23	9	0.31	9	0.12
10	0.24	10	0.33	10	0.13
11	0.28	11	0.38	11	0.15
12	0.32	12	0.4	12	0.16
13	0.36	13	0.42	13	0.17
14	0.4	14	0.44	14	0.18
15	0.44	15	0.46	15	0.21
16	0.48	16	0.48	16	0.24
17	0.52	17	0.5	17	0.27
18	0.56	18	0.52	18	0.3
19	0.6	19	0.54	19	0.33
20	0.64	20	0.56	20	0.36
21	0.68	21	0.58	21	0.39
22	0.7	22	0.6	22	0.41
23	0.72	23	0.62	23	0.43
24	0.74	24	0.64	24	0.45
25	0.78	25	0.67	25	0.48
26	0.82	26	0.7	26	0.51
27	0.86	27	0.73	27	0.54
28	0.9	28	0.76	28	0.57
29	0.94	29	0.79	29	0.6
30	0.98	30	0.82	30	0.63

Shënim: Pas vitit të 30 të përdorimit, të gjitha grupet e mjeteve rriten me koeficient vjetërsie 0.02.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ